



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI I BASHKISË

PLAN I AKTIVITETEVE TE KESHILLIT BASHKIAK

(Korrik-Dhjetor 2020)

Hartimit i planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornizë orjentuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Pogradec duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë se këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues. Ky plan aktivitetesh është orjentues dhe mundet të ndryshojë për çdo emergjencë, apo situatë të paparishikueshme në momentin e hartimit të tij.

Muaji Korrik

1. 2 mbledhje të Këshillit të Bashkisë duke pasur parasysh nevojat që ka administrata dhe funksionimi normal i Bashkisë për vendimmarrje si dhe realizimin e një mbledhje të dedikuar për analizën e buxhetit 6-mujor dhe realizimin e të ardhurave vendore në 6-mujorin e parë 2020.

(Administrata, Kryetari; Sek Keshillit),

2. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit , anëtarët e Komisioneve).

3. Realizimi i 2 konsultimeve publike (kërkesa ligjore) me temë:
 - a. “Për të dhënat financiare të buxhetit dhe realizimit të të ardhurave”. Takimi organizohet në formën e një debate të hapur nëpërmjet pasqyrimin të të dhënave dhe marrjes së mendimit në sallë ose edhe nëpërmjet organizimit të një debate të hapur me mediat sociale.
 - b. “Për ndryshimet ne buxhetin e vitit 2020”.

(Kryetari i Këshillit, Komisioni i ekonomisë, Sekretari i këshillit)

4. Realizimi i 1 konsultimi publik me temë: “Mbi kërkesën e një grupi biznesmenësh për përcaktimin e ditës së djelë si ditë pushimi”.

(Kryetari i Këshillit, Komisioni i ekonomisë, Sekretari i këshillit)

5. Vënia në funksionim e versionit final të rregjistrimit të ankesave, kërkesave dhe vërejtjeve (ligji nr. 139/2015, neni 19, ligji nr. 146/2014, neni 21).

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

6. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

7. Informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me zbatimin e Vendimit "Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Pogradec dhe ndërmarrjeve të varesive si dhe nivelit të pagave për vitin 2020", vendimarrjet e gjashtë mujorit të parë; njohja e Këshillit me urdhërat dhe vendimet në lidhje me punësimet, trajnimet e punonjësve, pozicionet të cilat ende kanë mbetur vakante, afatet për zhvillimin e konkurseve si dhe planifikimin e punës së kësaj drejtorie për periudhën Korrik-Dhjetor 2020.

(Drejtorja e Burimeve Njerëzore)

8. Informimi i Këshillit në lidhje me planin e sezonik turistik veror si edhe menaxhimin e hapësirave publike.

(Drejtorja e Planifikimit të Territorit)

Muaji Gusht

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i 3 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

4. Raportimi për masat e marra në insitucionet e arsimit parauniversitar, kopshte dhe çerdhe para fillimit të vitit mësimor.

(Sektori i Arsimit dhe shërbimeve në arsim)

Muaji Shtator.

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)
2. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).
3. Realizimi i 1 takimi me komuniteten e banorëve në qytet (kryesisht administrator pallatësh dhe anëtarë aktivë të komunitetit për mendime dhe nxitje për ngritjen dhe funksionimin e strukturave komunitare.
(Kryetari i Këshillit, Sekretari dhe koordinatoret e lagjeve në qytet)
4. Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga shoqatat e bashkive dhe për autzonomi vendore ose shkëmbim experience në bashki ku janë zbatuar Projekte pilot për Këshillat Bashkikë.
(Kryetari i Këshillit dhe anëtarë të Këshillit).
5. Trajnime nga donator ose shkëmbime experience ku janë zbatuar Projekte pilot për Këshillat Bashkiakë.
(Sekretari i Këshillit)
6. Realizimi i një emisioni në Median locale ku të promovohet roli dhe puna e Këshillit të Bashkisë si dhe të realizohen pyetje përgjigje në lidhje me çështje të Këshillit të Bashkisë.
(Kryetari i këshillit, Kryetarët e 2 komisioneve dhe Sekretari i Këshillit)
7. Ndërtimi dhe funksionimi i regjistrit elektronik të project akteve të Këshillit të Bashkisë. Dixhitalizimi i project vendimeve dhe berja e tyre publike përpara zhvillimit të mbledhjeve të këshillit dhe më pas arkivimi i tyre për tu parë nga cdo person i interesuar në faqen e Këshillit të Bashkisë. Ndërkohë do të bëhet dhe publikimi i vendimeve të miratuara ose nëpërmjet linkut ëëë.vendime.al ose në ndërfaqen e Këshillit të Bashkisë nëpërmjet një motori kërkimi.
(Sekretari i Këshillit dhe IT e Bashkisë)
8. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)
9. Raportimi i performancës dhe ecurisë së shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura.
(Sekretari i këshillit dhe UK sh.a. Pogradec)

Muaji Tetor

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)
2. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).
3. Konsultim publik (Diskutim i hapur me mediat sociale) për marrjen e mendimeve nga komunitetit për prioritetet e investimeve për vitin 2021.
(Sekretari i Këshillit, administrata)
4. Konsultim publik në lidhje me administrimin e banesave kolektive në zbatim të ligjit nr. nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.
(Sekretari i këshillit, Drejtoria e emergjencave dhe bashkëpronësisë)
5. Trajnime të Këshilltarëve të Bashkisë, kryesisht Komisioni i Ekonomi financës për buxhetimin dhe tarifat.
(Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë Financës)
6. Trajnim i Këshilltarëve për rolin monitorues të Këshillit të Bashkisë dhe për praktikën e buxhetimit me pjesëmarrje, në një Bashki të pilotuar dhe sygjëruar nga Projektet dhe donatorët.
(Anëtarët e Këshillit)
7. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)
8. Raportim mbi ecurinë e investimeve të vitit 2020.
(Sekretari i Këshillit dhe Sektori i prokurimeve, Punët publike etj)
9. Trajnim i Këshilltarëve Për implementimin e Rregullores për ankesat, Vërejtjet, Kërkesat, Peticionet, Nismat qytetare nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve me mbështetjen e Projektit Bashki të Forta.
10. U mbledh Asambleja e Aleancës së Zgjeruar të Grave Këshilltare (AZGKB) ku u zgjodhën 7 anëtarët e Bordit Drejtues nga të cilat u zgjodh Kryetarja, Nënkryetarja dhe sekretarja,

Muaji Nëntor

1. Realizimi i 2 mbledhjeve të Këshillit sipas nevojave për vendimarrje duke konsideruar dhe nevojat për tarifatat dhe buxhetin.
(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)
2. Realizimi i 5 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).
3. Realizimi i 10 takimeve konsultative me banorë dhe grupet e interesit për buxhetin 2021 dhe nivelin e tarifave 2021.
(Kryetari i Këshillit, Sekr. i këshillit, Anëtarët e Komisionit të ekonomisë).
4. Pjesëmarrje në konferencat e organizuara nga Min e Financave dhe Projektet e ndryshme për buxhetimin dhe sistemin e tarifave.
(Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë)
5. Ceremoni për dhënie titujsh nderi për vendimet e dhëna më herët nga Këshilli i Bashkisë.
(Kryetari i Këshillit dhe Sek. i Këshillit)
6. Organizimi i Festës së shpalljes së pavarësisë dhe çlirimit të vëndit.
(Kryetari i Këshillit dhe Sek. i Këshillit)
7. Pritja e delegacioneve nga Këshillat e Bashkive të tjera.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit)
8. Hartimi i Buxhetit të vitit 2021 për Këshillin e Bashkisë Pogradec së bashku me planin e aktiviteteve.
(Kryetari i këshillit, Sek. i Këshillit dhe komisioni i ekonomisë)
9. Hartimi i dokumentit të Politikës për Këshillin e Bashkisë mbi fushat prioritare ku do të fokusohet puna për vitin 2021 në mbështetje dhe të planit të veprimit për vitin 2021.
(Kryetari i këshillit, Kryesia e Këshillit dhe Sek. i Këshillit)

10. Realizimi i një ankete on-line për vlerësimin e punës së Këshillit nga komuniteti dhe grupet e interes.

(Kryetari i këshillit dhe Sekretari i këshillit)

9. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)

- 11.2 Raportime nga administrata e Bashkisë mbi:

- a. Realizimi ecurinë e zbatimit të akteve të Këshillit të Bashkisë. Analizë mbi aktet e miratuara, zbatuara.

(Sekretari i këshillit, Drejtorja juridike)

- b. Raportim mbi punën e realizuar në vitin 2020 për çështjen Gender dhe dhunën ndaj gruas.

(Sekretari i Këshillit dhe Komisioni I Këshillit për çështjet gender dhe sektori përkatës në Bashki)

Muaji Dhjetor

1. Realizimi i 2 mbledhjeve të Këshillit sipas nevojave për vendimarrje duke konsideruar dhe nevojat e fundvitit për vendimarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i 4 mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Realizimi i konsultimit publik mbi planin e aktiviteteve të nKëshillit për vitin 2021 së bashku me buxhetin dhe dokumentin e politikave.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari dhe Kryesia e Këshillit)

4. Realizimi i një konsultimi on-line me komunitetin mbi vlerësimin e shërbimeve që ka kryer bashkia dhe marrjen e mendimeve për vendosjen e standarteve të reja për kryerjen e këtyre shërbimeve.

(Sekretari i Këshillit së bashku me punët publike)

5. Realizimi im takimit vjetor me komunitetin për llogaridhënien e e Këshillit të Bashkisë. Organizimi i njëpublikimi on-line mbi aktivitetin e punën e Këshillit duke pritur komente dhe sygjerime nga komuniteti.

(Sekretari i Këshillit)

6. Ceremoni për dhënie tituj nderi për figura të spikatura të qytetit për vitin 2020.
(Kryetari i Këshillit dhe Sekretari i Këshillit)
7. Realizimi i një emisioni televiziv ku të pasqyrohet puna e Këshillit për vitin 2020 si dhe rezultatet e anketimeve dhe sygjërimeve të marra nga komuniteti.
(Kryesia e Këshillit)
8. Hartimi i planit vjetor 2021 të vendimarrjes së Këshillit.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit)
9. Hartimi i Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun për vitin 2021.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit).
10. Hartimi i planit 2 vjeçar për trajnimin e Këshilltarëve.
(Sekretari i Këshillit dhe Kryetari i Këshillit).
11. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë)
12. Raporti i auditimit të performancës së Këshillit të Bashksië.
(Sekretari i Këshillit dhe Auditi i Bashkisë)
13. Analiza e Drejtorisë të së Ardhurave për grumbullimin e taksave dhe tarifave vendore efektet në buxhet, planifikimi.
(Drejtoria e të Ardhurave)
- *Ky plan i aktiviteteve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*
 - *Cdo ndryshim im tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvillimit të aktivitetit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan dhe do të jetë objekt i monitorimit të performancës së Këshillit dhe do raportohet si i tillë në fund të vitit.*
 - *Takimet dhe konsultimet me komunitetin mund të realizohen edhe nëpërmjet rrjeteve sociale duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e dhënies së*

mendimeve dhe vërejtjeve nga të interesuarit. Cdo sygjerim, koment, apo mendim protokollohet nga Sekretari i këshillit dhe prezantohet në Komisionin përkatës apo mbledhjen e Këshillit.